



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 574

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Pjetërshticë

E martë, më 13 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 16:20 –17:30

Vendi i takimit: SHMFU "Idriz Ajeti"

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani dhe Drejtori i Shërbimeve Publike - Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar për bashkëpunimin e treguar dhe njëherit ka sqaruar rëndësinë e këtij takimi. Gjatë fjalimit, z. Ademi dha informata shtesë për banorët e fshatit Pjetërshticë sa i përket buxhetit të ndarë nga Komuna dhe në të njëjtën kohë kërkoi nga banorët që kërkesat e tyre t'i parashtrojnë dhe ato të cilat janë më primare për ta të vendosen në buxhetin e vitit 2024 për Pjetërshticën.

Pas z. Ademi, fjalën e mori Drejtori i Planifikimit Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtalb Emini, i cili e plotësoi më tej Kryesuesin duke dhënë informata më të hollësishme për banorët e këtij fshati. Drejtori Emini tregoi që takimi i sotëm po mbahet me qëllim të marrjes së kërkesave të banorëve dhe së bashku të vendosim për realizimin e tyre.

Kërkesat e banorëve të fshatit Pjetërshticë ishin:

- **Shaban Gashi:** Kërkesë që të rregullohet kanalizimi në të gjithë fshatin
- **Jakup Gashi:** Të rregullohet kanalizimi në rrugën "Aziz Dugolli"
- **Hafir Dugolli:** Të rregullohet lumi me gurë ose beton (Lumi Drenica), dhe të asfaltohet rruga "Shaqë Dugolli", në gjatësi 80 metra (lagjja Musolli)
- **Rexhep Gashi:** Ujësjellësi dhe kanalizimi të rregullohen në të gjithë fshatin
- **Kadri Gashi:** Të rregullohet rruga "Maliqi"
- **Musli Musolli:** Rruga nga ura e fshatit deri tek Kroni të ndriqohet dhe të pajiset me trotuar

- **Milaim Bajrami:** Rruga “Beqir Bajrami”, të asfaltohet në gjatësi 60 metra si dhe të asfaltohen rrugët “Idriz Ajeti” dhe “Agim Dugolli”

Procesmbajtës
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Vendi: Petërshitë

Date: 13.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Shaban Gashi	Sh
2	Endri Gashi	Endri
3	Sabit Gashi	Sabit
4	Jakup Gashi	Jakup
5	Avdullah Gashi	Avdullah
6	MUSLI MUSLI	MUSLI
7	Ullrich Basha	Ullrich
8	Hajir Duguti	Hajir
9	Perhap Gashi	Perhap
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		